



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:186980  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05722715

C.nr.2935/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Diora Bajrami, me bashkëpunëtoren profesionale E.H.M. në çështjen kontestimore të paditëses S.J. me numër personal ..... nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 399.23 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 22.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.J. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore Shtator- Dhjetor 2020, në shumën prej 2.89 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 147.63 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - 31.03.2022, në shumën prej 125.92 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 276.44 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (04.09.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 399.23 euro, përkatësisht shuma prej 122.79 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

## A r s y e t i m

S.J. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, pranë kësaj gjykate me datë 04.09.2023, përmes të autorizuarit të tij, av. A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa përmes parashtrësës së datës 15.11.2023, ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri më 31.03.2022, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në SHFMU “Meto Bajraktari” në fshatin Reçan, Komuna e Prizrenit, dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, është në lartësi prej 361.85 euro. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 20.12.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej 01.01.2019-31.03.2022 është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të datës 15.11.2023 si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës numër 159/22 e datës 16.12.2022 për paditësin e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit- e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “Meto Bajraktari”, si punëtor teknik.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 399.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.09.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 361.85 euro, gjykata pati parasysh që paga e paditëses sipas listës së pagave për muaj ka qenë në shumë prej 399 euro, mirëpo vendosi sipas kërkesës së paditëses e në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, andaj në pagën e kërkuar prej 361.85 euro i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 2.89 euro ( $361.85 * 0.2\% = 0.724 * 4 \text{ muaj} = 2.89 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 361.85 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 147.63 euro ( $361.85 * 3.4\% = 12.303 * 12 \text{ muaj} = 147.63 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 31.03.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 361.85 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 125.92 euro ( $361.85 * 11.6\% = 41.975 * 3 \text{ muaj} = 125.92 \text{ euro}$ ).
- Apo në shumë të përgjithshme prej 276.44 euro për periudhën prej dt. 01.09.2020 e deri me dt. 31.03.2022.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësit kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej 361.85 euro, edhe pse duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit ishte në lartësi prej 399.00 euro sipas listës së pagave por në kuptim të nenit 2 të LPK-së vendosi brenda kërkesës së paditësit, përkatësisht pagës së kërkuar në lartësi prej 361.85 euro.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 04.09.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2019 deri më datë 31.08.2020. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës nga data 01.01.2019 deri më datë 31.08.2020, pra shuma e tërësishme e parashkruar është në lartësi prej 122.79 euro.

Me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 04.09.2023, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.09.2020 e deri më 31.03.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 04.09.2023, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin shtator 2020, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin shtator 2020 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimi të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin shtator 2020 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht Tetor 2020, e njëjta ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (04.09.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo

juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.2935/2023, datë 22.05.2024

G j y q t a r e

\_\_\_\_\_  
Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.